

2016

SHKURT

1.02. 2016, Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes UGJ dhe Komitetit të Gjirokastrës (Società Dante Alighieri)

23.02. 2016 Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes UGJ dhe Universitetit "Ukshin Hoti" të Prizrenit.

MARS

▪ Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes UGJ dhe Universitetin për të Huaj të Sienës (Itali) – marrëveshje e cila sjell çdo vit në Universitetin tonë një praktikante/lektore të gjuhës italiane për të asistuar punën e lektorëve të Seksionit të Gjuhës Italiane në UGJ.

MAJ

▪ **10. 05.2016**, Vizitë me përfaqësues nga Universiteti i Halmstad (Suedi) – Prof.Hugo Palmaskold, Përgjegjës i Departamentit të Turizmit, Uni. Halmstad dhe Prof. Goran Sahlen, Departamenti i Biznesit dhe Inxhinierisë, Uni. Halmstad. Studentët dhe pedagogët e tyre do të njihen me kushtet, mundësitë për të shkëmbyer eksperiencën me kolegë e përfaqësues të UGJ.

▪ **12. 05.2016**, Salla e Mediatekes së Universitetit "Eqrem Çabej" zhvillohet ceremonia e nderimit të Prof. Francesco Altimari me titullin "Honoris Causa". Prof. Francesco Altimari, si personalitet me një kontribut e angazhim të spikatur e të palodhur në bashkëpunimin me departamentet e gjuhësisë dhe letërsisë të universitetit të Gjirokastrës.

QERSHOR

▪ **01. 06.2016**, Fillimi i iniciativës "English Coffee" – një bashkëpunim ndërmjet vullnetarëve të Korpusit të Paqes dhe Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë në UGJ – ku studentë dhe të intersuar të gjuhës angleze takohen një herë një javë për të diskutuar për çështje të ndryshme në gjuhën angleze.

▪ **09. 06.2016**, Takim informativ me studentët për t'i njohur ata me privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave dhe të drejtën për informim, organizuar nga Sektori i Komunikimit me Median dhe Publikun, Drejtoria e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Takim në formën e bashkëbisedimit me qëllim njohjen e studentëve me privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave si dhe të drejtën për informim.

▪ **09. 06.2016**, Ditë Trajnimi mbi Programet Europiane – informacion mbi aplikime për projekte- në kuadër të Thirrjeve për Projekte që ka shpallur Programi Kuadër i BE-së për Kërkim-Shkencor e Inovacion- Horizon 2020.

QERSHOR

Organizimi në mjediset e universiteti "Eqrem Çabej", DT. 09.06.2016, me stafin akademik të aktivitetit në kuadrin e projektit "Forcimi i kapaciteteve në nivel kombëtar për pjesëmarrje në programin kuadër të BE-së për kërkim shkencor dhe inovacionin Horizont 2020(2014-2020) financuar nga Komisioni Europian, Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit(AKTI), një ditë trainimi me qëllim informimin dhe trainimin e tyre mbi Programet e reja Europiane që financojnë edhe mbështesin Kërkimin shkencor si: Horizont 2010, Marie Skłodowska- Curie Action 9msca), European Research Council (ERC) Grant dhe prezantimi i rrjetit EURAXESS.

▪ **15. 06.2016**, Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes UGJ dhe Universitetit të Beogradit (Serbi).

TETOR

▪ Në dt. 14/10/2016, në ambientet e Universitetit "Eqrem Çabej" u organizua seminari me temë: "Mësimdhënia me qëndër Studentin , sfida e re e IAL-ve".

NENTOR



- UGj merr pjesë në : IAU (International Association of Universities), 15th General Conference, HIGHER EDUCATION, a catalyst for innovative and sustainable societies 13-16 November 2016, Chulalongkorn University Bangkok, Thailand.

DHJETOR

- Takim për aktivitete Erasmus 5 Dhjetor, në ambientet e Mediatekes : **Info Day Erasmus+ ku u prezantuan thirrjet e reja të programit Erasmus+ për:**
 1. Projektet CBHE (Capacity Building Higher Education), Marrëveshjet ICM (International Credit mobility).
 2. Prezantimin nga zyra e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve të ICMve për stafin dhe studentët; Aplikimet individuale për Joint master/PhD (studentët);
 3. Jean Monnet.
- Universiteti “Eqrem Cabej”, në bashkëpunim me Teatrin “Zihni Sako” zhvilloi mbremien poetike “Vargjet E skenës nga mjeshtrat e mëdhenj të penës”, në dt. 20.12.2016 në sallën në auditorit të Universitetit “E.Cabej”.

2017

SHTATOR

Në kuadër të programit Erasmus + **International Credit Mobility 2016-2018**, nga Universiteti I Gjirokastrës tre student të Fakultetit të Shkencave të Natyrës fitues të aplikimit në këtë program, filluan frekuentimin e programeve të studimit në Universitetin I Galicisë të Spanjës për periudhën simestrale shtator (2017) –shkurt (2018).

TETOR

- Në Universitetin “Eqrem Cabej” në 1. 10. 2017 nënshkruhet marrëveshja kuadër me Universitetin e Studimeve të Huaja të Pekinit. Gjatë këtij takimi të dy rektorët u shprehën për gadishmerinë e bashkëpunimit në disa fusha të përbashkëta vecanerisht në gjuhë shqipe, albanologji, programet e gjuhëve angleze, italiane etj, hapjen e kurseve verore për mesimin e gjuhës kineze që do të lehtësojë shkëmbimin e stafit studentor dhe akademik midis dy universiteteve.



- 26.10.2017, Komiteti Shqiptar I Helsinkit , organizoi Forum e hapur në bashkëpunim me Universitetin “Eqrem Cabej” “Shoqëria Civile kundër Ekstremizmit të dhunshëm”. Ky aktivitet realizohet në kuadër të projektit “Shoqëria civile kundër ekstremizmit të dhunshëm”, mbështetur financiarisht nga BE.

- Universiteti “Eqrem Cabej” Gjirokastrë Fakulteti i Edukimit dhe i Shkencave Shoqërore Departamenti i Letërsisë Departamenti i Gjuhës Shqipe në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë dhe Akademinë e Studimeve Albanologjike, Tiranë organizuan në dt. 30.10.2017 Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Kontributi i Prof. Rexhep Qosjes në kulturën shqiptare”.

NENTOR

- UGJ në bashkëpunim me shoqatën “Psikologët Shqiptarë”, në ambientet e Universitetit “E



Cabej në datat 24-25 Nëntor 2017 organizoi Konferencën Kombetare “Kurrikula dhe sfidat në arsimin parauniversitar”.

- Në dt 29-1 Nëntor 2017, organizohet takimi i pare I partnereve në projektin e fituar “Developing teacher competences for a comprehensive vet system in Albania TEAVET, ku UGj eshte partnere. Ky takim u organizua ne universitetin Leon te Spanjes .

DHJETOR

- Në dt. 01-02 Dhjetor 2017 Departamenti I Gjeografisë në Universitetin e Gjirokastrës në bashkëpunim me Departamentin e Gjeografisë në Universitetin e Tiranës organizuan Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “**HAPËSIRAT NDËRKUFITARE. DINAMIKA DHE SFIDA**”.
- Departamenti i Letërsisë, FESHSH Universiteti “E.Cabej” në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë dhe Akademinë e Studimeve Albanologjike, Tiranë ne dt. 11.12.2017 prane Universitetit E.Cabej, organizoi Konferencen Kombetare “Personaliteti shkencor e akademik i Jorgo Bulos”.
- Nënshkruhet Marrëveshja e bashkëpunimit në kuadrin e programit ERAZMUS me Universitetin e Turkut të Finlandës.
- Nënshkruhet Marrëveshja e bashkëpunimit në kuadrin e programit ERAZMUS me Universitetin e Maqedonisë Perendimore, në fushën e edukimit.

Viti 2018-2019

JANAR

Pjesëmarrje në Ëorkshopin organizuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), në bashkëpunim Projektin e Asistencës Teknike mbi Thirrjet e Ardhshme 2018-2019 të Programit Horizon 2020, për Programet Europiane në Shqipëri, datë 10 Janar 2018.

- Nënshkruhet Marrëveshja e bashkëpunimit në kuadrin e programit ERAZMUS me Universitetin (TEI) e Kretës.
- Rinovohet Marrëveshja Institucionale me Universitetin e Qipros.
- Në Universitetin e Janinës, një grup I përbërë nga stafi akademik I UGJ u bë pjesë e një takim – diskutimi me homologët përkatës mbi mundësitë dhe veprimet e nevojshme për implementimin e marrëveshjes dypalëshe. Kjo marrëveshje do ti hapë rrugën vazhdimësisë dhe bashkëpunimit në fushat: shkëmbim stafi akademi, studentor dhe administrative midis dy universiteteve, organizime të veprimatrive të përbashkëta mësimore kërkimore- shkencore.



SHKURT

- Takimi I dytë në kuadrin e projektit TEAVET , në Universitetin e Elbasanit në dt. 7.2. 2018 – 9.02.2018 .
- Zyra e Marrëdhënieve me jashtë dhe projekteve, publikoi thirrjet për aplikime të stafit akademik (mësimdhënie & trajnim) dhe studentor në Universitetet : Turqi, Greqi, Spanjë, dhe Finlandë.

MARS

▪ Takim dt. 13.03.2018 në Ugj me nje grup drejtuesish nga departamenti I Edukimit te Universitetit te janines. Qellimi I ketij takimi diskutimi për implementim konkret të marrëveshjes së bashkëpunimit institucional midis dy universiteteve në fushën e edukimit.

▪ Në dt. 16.03. 2018 nga UGJ, në bashkëpunim me drejtorinë arsimore Rajonale dhe të fuar të tjerë u organizua aktiviteti me rastin e **Ditës botërore (10 vjetorit) të fëmijëve me sindromën doën.**

▪ Ne jemi NATO, takim dt. 19.03. 2018, organizuar ne ambientet e UGJ-se me perfaqësues të Këshillit Atlantik: Z. A. Starova, K. Birbo dhe D. Demiraj.

▪ Departamenti I Gjuhës Shqipe dhe I Letërsisë në **Ditën Botërore të Poezisë** në bashkëpunim me zyrën e Këshillimit të karrieres dhe bibliotekës së Universitetit “E.Cabej”, me 21 Mars 2018 organizoi aktivitetin “ **Të ndryshosh jetën nëpërmjet poezisë**”. Aktiviteti u organizuar në sallën e Mediatekes së Universitetit “E. Cabej”.

▪ **Pjesëmarrje e UGJ-së në 4th Annual Conference of the Balkan Universities Association** "Collaboration between Universities and Cultural Coexistence - a premise for a sustainable platform in overall Balkan area" **30-31 March 2018, University of Tetova, Macedonia**

PRILL

▪ Gjate periudhës 24-27 Prill, një grupi pedagogësh nga UGj mori pjesë në takimin e tretë, trajnues, në kuadrin e projektit TEAVET organizuar në Universitetin e Turkut në Finlandë.

▪ Ne 23 prill 2018, Diten Botërore të librit, Biblioteka e Universitetit “E Cabej”, organizoi ekspoziten e librit : “50 Vjet Universiteti I Gjirokastrës”.

▪ Më 24 prill, Ambasadori Alberto Cutillo me ftesë të Rektorit të Universitetit "Eqrem Çabej" Prof. dr. Bektash Mema, bëri një vizitë në Universitetin Eqrem Çabej ku së pari u mirëprit në Rektorat dhe pati një bisedë të frytshme. ku u ritheksuan bashkëpunimet e vazhdueshme ndërmjet universitetit "Eqrem Çabej dhe Italisë. Më tej ambasadori Cutillo mbajti një leksion të hapur me studentë dhe stafin akademik të universitetit me temë "Sfida e Bashkimit Evropian dhe rruga e integritetit të Shqipërisë."

▪ Në dt 27.04.2018, Biblioteka e Universitetit “E. Cabej”, bashkëpunim me Departamentet Histori-Gjeografi, organizoi **konferencën studentore** “Kontributi I fondit bibliotekar ne aftësimin shkencor të studentëve të degës Histori-Gjeografi.

▪ Në vazhden e aktiviteteve që do të zhvillohen nga Universiteti "Eqrem Çabej", me rastin e 50-vjetorit të hapjes së Arsimit të Lartë në Gjirokastrë, Federata Sportive e Universiteteve, Këshilli Studentor i UGJ-së në bashkëpunim me qendrën e Alumnit dhe formimit të vazhduar dhe studentët e UGJ-së zhvilluan aktivitetin sportiv në disiplinën futboll me ekipin e studentëve të Universitetit "F. Noli" Korçë. Ky aktivitet u zhvillua në formën e ndeshjes miqësore midis studentëve të secilit Universitet në datën 27 Prill 2018.

▪ Në kuadër të 50 vjetorit të hapjes së Arsimit të lartë në Gjirokastrë, qendra e Alumni-it dhe formimit të vazhduar, në bashkëpunim me Federatën Sportive të Universitetit organizoi aktivitetin në disiplinën mini futboll, midis Fakulteteve të UGJ. Aktiviteti u zhvillua në datat 17,18,19.Prill.2018, në ambientet e "Pallatit të Sportit", Gjirokastrë.



MAJ

▪ Nga zyra e Marrëdhënieve me Jashtë Të UGJ, publikon thirrjet : Application for **Mevlana Exchange Program** Gjirokastra University have nominated the name of Academic Staff as folloëing to **TRAKYA UNIVERSITESI**.

▪ Në kuadër të zhvillimit të kampionatit kombëtar të Sportit Universitar, Universiteti "Eqrem Çabej", në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Sporteve, U.GJ zhvilloi aktivitetin sportiv në disiplinën "minifutboll", për meshkuj me ekipin e Universitetit "Fan.S.Noli" Korçë. Me mbështetjen e ekipit të U.GJ. ishte z.Arjan Pano, pedagog i edukimit fizik në departamentin e Edukimit dhe Metodologjisë në Mësimdhënies. Qelimi kryesor i aktivitetit ishte gjallërimi i jetës studentore. Aktiviteti u zhvillua në "Pallatin e Sportit", të qytetit Gjirokastrës në datë 04 Maj 2018, ora 11⁰⁰.

▪ Qendra Europiane, organize trajnimin 1 ditor në Universitetin "Eqrem Çabej" në datë 18 maj 2018, me studentë të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore. Gjatë trajnimit dy eksperte, znj. Ina Xhepa dhe znj. Adea Pirdeni folën mbi: Ndryshimet Kushtetuese; Ligji i vetëqeverisjes dhe organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Aktiviteti u mbajt në sallën e Mediatekes data 18 Maj 2018.

▪ Në qëllim të realizimit të aktiviteteve të Kampionatit Kombëtar të Sporteve Universitare, ekipet studentore të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Sporteve, zhvilloi aktivitetet sportive në disiplinat "Volejbolli" (vajza) dhe "Minifutbolli" (djem) me ekipet studentore të Universitetit të Tiranës. Qëllimi i aktiviteteve ishte gjallërimi i jetës studentore. Aktiviteti u zhvillua në "Pallatin e Sportit" të qytetit Gjirokastrës më datë 25 Maj 2018, ora 11⁰⁰.

▪ Dt 30.05.2018 në kuadrin e implementimit të Marrëveshjes me Universitetin e Janines, ky i fundit mbështeti dhe priti studentët e programeve Bachelor dhe master të degës Histori-Gjeografi në ambientet e Universitetit . Rektori Z. Kapsalis organizoi turin në ambientet e universitetit duke siguruar dhe viziten në shpellën e Peramas, muzeun Bizantin etj.

QERSHOR

▪ Në dt. 04.06.2018 në ambientet e Universitetit "E Çabej", u organizua takimi me përfaqësues të shoqatës Tirana pjesë e fondacionit për dëshmorët "SKARD". Ky takim u organizua në bashkëpunim me Departamentet Gjuhë, Letërsi, DEMM si dhe Biblioteka e Universitetit "E Çabej".

KORRIK

Dt. 10.07.2018 Takim me ambasadorin turk në Tiranë. Në ambientet e Ugj nga rektorati u prit ambasadori turk dhe stafi i tij. Takimi u zhvillua në frymën e suportit të Ambasadës Së Turqisë në Tiranë për forcimin e bashkëpunimit me universitetet turke, mobilitetin e stafit akademik dhe studentor në drejtimet: mësimdhënie, trajnime dhe projekte të përbashkëta.



SHTATOR

▪ Në universitetin Eqrem Çabej në dt. **17.08 2018**, u zhvillua takimi me një grup profesorësh nga Shkolla Superiore e Restaurimit dhe Konservimit në fushën e arkeologjisë **Universiteti I Madridit, Spanjë**. Pikat referuese të diskutimit përfshinin nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi midis dy universiteteve dhe në këtë kuadër zgjerimin e mobiliteteve për staf akademik dhe studentor, bashkëpunime si partner




në projekte të përbashkëta, ngritja e shkollave verore për studentët e Departamentit Histori-Gjografi dhe ciklit të dytë të studime në Masterin Shkencor për Arkeologji.

- Në kuadrin e bashkëpunimit të Muzeut tonë Kombëtar dhe atyre të Rumanisë, në dt.

19.09.2018, në rektoratin e Universitetit "E. Cabet", u prit drejtori i muzeut të Bukureshtit Z. **Adrian Majuru** i shoqëruar nga drejtues të tjerë të muzeumeve të këtij vendi si dhe nga sopranoja shqiptare dhe atashe kulturor i Shqipërisë në Rumani, Linda Morava. Në takim ishin prezente dhe Z. Kumbarko Ministre e Kulturës. Prof. Majuru referoi temën: **Fytyra e Bukureshtit, "Ndryshimi i pamjeve të qytetit dhe jetës së përditshme"**.

TETOR

▪ Në 24 Tetor 2018, në ambientet e Universitetit "Eqrem Cabet" u organizua **Konferenca Shkencore Kombëtare "ZHVILLIME GJUHËSORE DHE LETRARE NË PERIUDHËN E PAVARËSISË"**. Kjo konferencë u organizua nga Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë të Universitetit "E Cabet", Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë dhe Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë. Kjo konferencë u organizua në kuadër të 50-Vjetorit të Universitetit "E Cabet" dhe të Vitit të Skënderbeut.



▪ Në datat 04-06 Tetor 2018, në Universitetin e Gjirokastrës zhvilloi punimet "**Kongresi i 8 Të Ndërkombëtar mbi Dialektet e Greqishtes Moderne dhe Teoritë Gjuhësore**". Gjithashtu u përfshinë dhe veprimtaritë kushtuar 25 vjetorit të Departamentit të Gjuhës Letërsisë dhe Qytetërimit Grek.



Kongresi si një mundësi njohjeje dhe kontakti të Universitetit tonë me botën akademike të shumë shteteve të botës perendimore e lindore, vërteton se Universiteti ynë është i hapur ndaj dijes e shkencës.

NENTOR

▪ Qendra Alumni dhe Formimi i Vazhduar për studentët në Universitetin "E Cabet", zhvilloi në dt. **08/11/2018** aktivitetin me temë: Informimi i përgjithshëm i studentëve të vitit të parë. Ky aktivitet kish për qëllim që çdo student të informohet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij si dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimit Studentor.

- MASR në bashkëpunim me Fondin e Kombeve të Bashkuara dhe Olof Oalme Center



Albania, realizoi konsultimin publik në Universitetin “E Cabej”, në dt. 9.11.2018 për “Përfshirjen e të rinjëve në procesin e konsultimit të projekt ligjit të rinisë.

- Në datën 26 Nëntor, 2018, në ambientin e auditorit u organizua leksioni i hapur për të njohur studentët e Universitetit “Eqrem Cabej”, me Programin Global UGRAD. Programi në fjalë financohet nga Departamenti i Shtetit dhe jep bursa për studentë të nivelit universitar.

DHJETOR

- KQZ , në përmbushje të misionit institucional, dhe në vlerësim të rëndësisë së informimit dhe nërgjegjësisë të brezit të ri për çështjet zgjedhore, organizoi në ambientet e Universiteti “E Cabej”, dt 06.12.2018, sesione me studentët mbi temat: Sistemi zgjedhor, cikli zgjedhor, administrate zgjedhore etj.

- Organizohet në dt. 7/12/2018 në ambientet e Universitetit “Eqrem Cabej”, festimi i “50 vjetorit të Arsimit të lartë në Gjirokastrë”. Festimi u shoqërua nga një axhendë institucionale ku Rektori Z. Mema përpara të ftuarve ardhur nga universitetet shqiptare dhe të huaja si dhe të ftuarëve e pranishmëve të tjerë mbajti fjalën e mirëseardhjes si dhe një historik përmbledhës të fillimeve të studimeve të larta në Gjirokastrë.

- Takim me Universitetin e Macherates ne UGJ përfaqësuar nga Prof. Perna dhe Z. Ferreti i Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë. Diskutimi perfundimtar I draftit mbi programin e dyfishtë në Administrimin e Trashëgimisë Historike, Arkeologjike dhe Kulturore”.



2019

JANAR

- Ditën e mërkurë në dt. 30/01/2019, në ambientet e UGJ u organizua: Forumi I hapur “Angazhimi I studenteve në procesin e Integrimit Evropian të Shqipërisë”. Ky takim erdhi si një bashkëpunim me Ambasadën e Hollandës në Tiranë dhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit. Takimi u zhvillua në bazë të një axhende të paracaktuar ku studentët u bënë pjesë e një pyetesori mbi çështjet : Çështje BE, institucionet e saj etj, ndërsa u informuan më tej për mundësitë e përfshirjes dhe angazhimit të tyre në këtë proces që I përket të sotmes dhe të ardhmes së vendit. Studentë të UGJ përfitues të Programit Erasmus + ndanë eksperiencën e tyre në këtë takim.



SHKURT

▪ Në ambientin e auditorit të Universitetit “Eqrem Cabej”, dt.08/02/2019 u organizua “Dita botërore e gjuhës Greke, si një bashkëpunim i Konsullatës Greke në Gjirokastrë dhe Departamentit të Gjuhës Letërsisë dhe Qyteterimi Grek. Rektori i UGJ Z. Mema dhe Konsulli i Greqisë në Gjirokastrë Z. Kakissis përshëndetën pjesëmarrësit dhe aktivitetin . Aktiviteti u pasua nga kumtimet të referuara nga Departamenti i Letërsisë dhe Qyteterimi Grek si dhe nga disa dokumentarë mbi lashtësinë e gjuhës dhe kulturës helene.



PRILL

Universiteti i Gjirokastrës në dt.11 Prill merr pjesë në inagurimin e vitin akademik të Universiteti Macerates – Itali i themeluar në vitin 1290. Eventin e përshëndetën akademikë, rektor, përfaqësues të stafit teknik dhe administrativ, student si dhe rektorë dhe përfaqësues të universiteteve të tjera, me të cilat UNIMC ka ndërtuar kurse që kulmojnë në programe të përbashkëta studimi dhe diplomimi. Në përfundim të eventit, profesorët Donatella Bisconti (Universiteti i Clermon Auvergne), Valbona Duri (Universiteti i Gjirokastrës), Henri Sardaryan (Universiteti Shtetëror i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Moskë - MGIMO), Zhou Zuoyu (Universiteti Normal i Pekinit) etj, kanë firmosur në një pergamenë, një lloj angazhimi paraprak për të ardhmen , “Karten e Maceratës”, një dokument për të mbajtur gjallë marrëdhëniet midis universiteteve, kulturave dhe dialogut.

▪ Ugj merr pjesë në takimin e 5-të të Shoqatës(Rrjetit) së Universiteteve Ballkanike organizuar në Universitetin “Aristoteli” të Selanikut në dt 16-18 Prill, ku UGJ është prej vitit 2006 anëtare. Takim ky që i mbledhi sëbashku universitetet e Ballkanit në Konferencën Shkencore me temë: “Roli i Universitetit në Zhvillimin e Qëndrueshëm”.

MAJ

▪ Takim në ambientin e Rektoratit me Rektorin e Universitetit Prizrenit, Dekanin e Fakultetit të Edukimit dhe administratorin e këtij universiteti, ku u bisedua mbi mundësitë e implementimit të bashkëpunimit në vijim .

QERSHOR

▪ Dt.4/06/19 Takim i rektoratit të UGJ me përfaqësuesit e Universitetit të Macerates mbi finalizimin e dokumentacionit të Programit të Studimit Master me titull të dyfishtë “ Arkeologji, Histori dhe Administrim i pasurive kulturore” të Universitetit të Gjirokastrës dhe “Kërkime historike dhe burimet e kujtesës” të Universitetit të Maçeratës.

▪ Pritje nga Zv\rektori për Shkencën dhe marrëdhëniet me jashtë të stafit akademik të ardhur nga universiteti i Galicias dhe Instituti i Restaurimit Madrid, Spanjë.



- Në ambientet e UGJ më 20.05.2019, organizohet takim promovimi i teksiti universitar “Statistika përshkruese”, teori dhe ushtrime, e autoreve Besnik Nuredini dhe Bashkim Kamberi. Ky botim do tju vijë në ndihmë studentëve të Fakulteti ekonomik të cilët në peogramet e studimit zhvillojnë disipinën e statistikës.

KORRIK

- Në ambientet e bibliotekës së UGJ u organizua ceremonia e dhurimit nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë të **150** tituj librash, deshmi e vazhdimësisë së bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve tona. Ky fond do të pasurojë bibliotekën tona do të shërbejë me mirë procesit mesimor dhe atij shkencor, në ndihmë të studentëve, pedagogëve, studiuesve të shkencave albanologjike dhe jo vetëm.. ky fond përmban Studime historike, gjuhësore, gjeografike, filologjike etj.

SHTATOR

- Në kuadër të Projekti: Projekti Erasmus Plus: TEAVET (2017-2020) në muajin shtator në datat 5-6 në Universitetin “Eqrem Çabej” u krye takimi i radhës. Nga bashkëpunimi i universiteteve pjesëmarrëse dhe IZHA pranë MASR është bërë i mundur akreditimi i 16 moduleve. Edhe universiteti “Eqrem Çabej” ka të drejtën e trajnimit të mësuesve të arsimit parauniversitar me këto 16 module të akredituara.
-
- Shtator 5.9.2019 në zyrën e zëvendësrektorës për shkencën dhe Marrëdhëniet me jashtë organizohet takimi me kordinatorin e programit Erazmul për universitete të Spanjës z. Amador Ordonez. Bashkëpunimi me universitet spanjollë në kuadrin e programeve të mobiliteti për trajnim dhe mësimdhënie dallohet për intensitetin e ndërsjelltë.
- Në dt. 11.09.2019 zhvillohet takim konsultativ midis përfaqësuesve të dy universiteteve Gjirokastrës dhe Maceratës mbi plotësimin e dokumentacionit për hapjen e programit dual Master Shkencor ASPIK “ Arkeologji. Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore”, në kuadrin e marrëveshjes së bashkëpunimit dypalësh të UGJ dhe Universitetit të Maceratës(Itali).

